



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr 58 datë 15/10/2022

“ Per rinovim kontrate per dhenien me qera te parcelave ”


Në zbatim të Ligjit Nr 139/2015 “Për qeverisjen Vendore”, të nenit 19 e vijues të ligjit Nr. 9385 datë 04.05.2005 “ Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor” të ndryshuar, të ligjit Nr. 9693 datë 19.03.2007 “ Për Fondin Kullosor ” të ndryshuar ,VKM-së Nr 433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit”, vendimit të Këshillit të Ministrave Nr 434 datë 08.06.2016 për disa shtesa dhe ndryshime të VKM-s 1353 datë 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe paraqitjen e kërkesës,mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik,si edhe të kriterëve dhe të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të fondit pyjor ”, vendimit të Këshillit të Ministrave Nr 435 datë 08.06.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime të VKM-s 1374 datë 10.10.2008 për përcaktimin e rregullave,procedurave që ndiqen për heqjen,shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”,udhëzimit nr 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat e procedurat e kërkimit ,shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik” pika 23, si edhe të nenit 801 e në vijim të ligjit Nr.7850. date 29.07.1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, ne vijim te kontrates nr. 5773 prot date 07.12.2017, të kërkesës së subjektit HEC “ LASHKIZA DHE HIDROSETA” shpk nr . 14 prot date 04.06.2022, kerkeses nr. 3595 prot date 14.07.2022 per rinovim te kontrates per parcelat e Linjës Elektrike në fshatin Kodër Leshe ,në Njësinë Administrative Arras-; Fushe Cidhen Nj.A Sllove , Keshilli Bashkiak ne mbledhjen e dates 15.07.2022 me 17 vota pro,1 kunder dhe 0 apstenim

VENDOSI:

1. Të miratoje kerkesen e subjektit HEC “ LASHKIZA DHE HIDROSETA” shpk nr . 14 prot date 04.06.2022, nr. 3595 prot date 14.07.2022 per rinovimin e kontrates te qerese, per dhenien me qera te parcelave sipas hartes bashkelidhur ketij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Bashkia Diber.

3. Ky vendim u shpall sot me date 15.07.2022.

KRYETARI I KESHILLIT BASHKIAK




Date 12.07.2022

Lenda : Kerkese per miratim per rinovim kontrate per linjen elektrike

Drejtuar : Keshillit Bashkiak Diber

Per dijani : Kryetarit te Bashkise z. Rahim Spahiu



Ne referim te kontrates te qerese nr 5773 prot date 07.12.2017 per dhenie ne perdorim te fondit Pyjor dhe Kullosor Kombetare afati i te ciles ka mbaruar eshte e nevojshme rinovimi i saj, per te cilen per procedure kerkohet miratimi i kerkeses ne mbledhjen e keshillit Bashkiak Diber.

Per efekt dokumentacioni mbetemi me shprese qe kerkesa jone te trajtohet nga ana juaj brenda afateve ligjore.

Ju falenderojme per bashkepunimin.

Me respekt,

ADMINISTRATORI

Liljana DELIA

